



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 17736 Prot.

Lezhë, më 06 . 10 .2021

VENDIM

Nr. 139 Datë 04 . 10 .2021

PËR MIRATIMIN E PBA-së 2022-2024 TË BASHKISË LEZHË (FAZA E DYTË).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 24.07.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

- 1.Miratimin e PBA-së 2022-2024 të Bashkisë Lezhë për fazën e dytë, sipas projekt/dokumentit të paraqitur të Instrumentit të Planifikimit Financiar (IPF) dhe relacionit përkatës, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

